



## Që të them: "Subhanallah (i patëmeta është Allahu), elhamdulillah (lavdërimi i takon Allahut), la ilahe il-lallah (nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut) dhe Allahu ekber (Allahu është më i madhi)" është më e dashur tek unë se çdo gjë që Dielli e përshkon kur lind

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Që të them: "Subhanallah (i patëmeta është Allahu), elhamdulillah (lavdërimi i takon Allahut), la ilahe il-lallah (nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut) dhe Allahu ekber (Allahu është më i madhi)" është më e dashur tek unë se çdo gjë që Dielli e përshkon kur lind."

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith na tregon se përmendja e Allahut të Lartësuar me këto fjalë madhështore është më e mirë se kjo botë dhe çdo gjë në të. Këto fjalë janë: Subhanallah - është lartësim për Allahun nga çdo mangësi. Elhamdulillah - është lavdërim për Allahun përmes cilësive të përkryera, duke e dashur dhe madhëruar. La ilahe il-lallah, respektivisht nuk ka zot që meriton të adhurohet denjësisht pos Allahut. Allahu ekber - është më madhështori dhe më i madhi se çdo gjë.

<https://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/6211>

